



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

|  |                               |                               |                               |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Planuar / Dorezuar<br>Priljevoj / Prodato<br>Received / Delivery | 28.09.2022                    | 2                             | viti<br>god<br>year           |
| Organ / Njësia<br>Org / Jedinica<br>Org / Unit                   | Nr Prot<br>Br Prot<br>Prot No | Shtojca<br>Prilóg<br>Appendix | Sasia<br>Kolicina<br>Quantity |
| SKIMSHCK   | 5740/2022                     |                               | 1/6                           |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova**  
**Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo**

A.nr.686/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: : Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.686/2022 me datë 03.08.2022 e parashtruar nga ankuesi me adresë: rruga

Komuna e Prishtinës, kundër Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “Vlerësimi i rezultateve të punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.09.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.686/2022 e datës 03.08.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. NDRYSHOHET** Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2021 i datës 26.07.2022 lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit për ankuesin nga nota (2.1) në notën e përgjithshme (2.5).
- III. Ky Vendim** zëvendëson Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë si në pikën II të dispozitivit dhe i njëjti të përfshihet në dosjen personale dhe regjistrat përkatës të nëpunësit civile.
- IV. OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrinë se Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës në pozitën: "Udhëheqëse i Divizionit të Projekteve", në Departamentin e Infrastrukturës Rrugore, i pa kënaqur me rivlerësimin e datës 26.07.2022 për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë, respektivisht Drejtori i Departamentit të Infrastrukturës Rrugore, sipas Vendimi me numër Anr.186/2022 të datës 12.04.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili vendim ka obliguar Udhëheqësin e drejtpërdrejtë të ankuesit që ankuesit ti bëjë rivlerësimin e rezultateve në punës për periudhën nga data 01.01.2021 deri e datë 31.12.2021 në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Ankuesi me datë 03.08.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër rivlerësimit të datës 26.07.2022 me të cilin ankuesi është vlerësuar me notën të përgjithshme 2.1 mjaftueshëm, pothuajse me të njëjtën notë siç është vlerësuar në formularin e vlerësimit për rezultatet në punë për vitin 2021, i lëshuar me datë 04.02.2022, me pretendimet ankimore se rivlerësimi është bërë i njëjtë nuk është objektiv dhe i pabazuar në prova dhe fakte, është bere me shkelje të afateve ligjore të vlerësimit gjegjësisht ri vlerësimi si i tillë është bërë në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrat e Publik dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, duke propozuar që ti aprovohet ankesa dhe të anulohet rivlerësimi i datës 26.07.2022.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.09.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.97/2022, lidhur me vazhdimin e afatit për ankesën me numër Anr.688/2022 të datë 03.08.2022 të ankuesit edhe dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova:** Ankesa A.nr.686/2022 të datës 03.08.2022 me numër protokolli 4497/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ri-vlerësimi i datës 26.07.2022 i nxjerrë nga Drejtori i Departamentit të Infrastrukturës Rrugore; Vendimin Anr.186/2022 e datës 13.04.2022 me numër protokolli 2078/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari i datës 26.07.2022, për ri-vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021; Ankesë e datës 28.02.2022 me nr.protokolli 1035 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Objektivat për vitin 2020 i datës 31.12.2019; Formulari i datës 31.12.2019, për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2019; Formulari i datës 05.02.2022, për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021; Përgjigje në ankesë e datës 14.03.2022 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës; Akt emerimi i datës 04.05.2012; Vendimi Nr.8397 i datës 04.09.2018; Detajet e planit vjetor të punës nga i njerrë nga sistemi; Vendimin me numër Nr.97/2022 i datës 15.09.2022 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Emaili i datës 12.09.2022 i Këshillit derguar Njesise së Burimeve Njerezore ;, Emaili i datës 27.09.2022 derguar Këshillit nga Njesia e Burimeve Njerezore.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se rivlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021, nuk është objektiv dhe i pabazuar në prova dhe fakte, gjegjësisht vlerësimi i është bërë në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyratë Publik dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të

Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore-thelbësore në vlerësim dhe rivlerësim të vlerësimit të punës, shkelje të afateve ligjore të vlerësimit si dhe edhe se po ashtu ankuesi pretendon se nuk është thirr në takim respektivisht nuk është zbatuar Vendimi me numër Anr.186/2022 i datës 12.04.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, gjegjësisht vlerësuesi me datë 26.07.2022 përmes e-mailit zyrtar e dërgon Formularin e rivlerësimit të rezultateve në Punë për vitin 2021, për ankuesin me notën e përgjithshme 2.1, pothuajse njëjtë ashtu siç është vlerësuar dhe në vlerësimin e datës 04.02.2022.

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezultojnë se ankuesi sipas Aktit të emërimit të datës 04.05.2012 është i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pozitën "Zyrtar i Projekteve për Rrugë", në Departamentin e Infrastrukturës Rrugore, ndërsa në bazë të vendimit nr.8397 të datës 04.09.2018 është caktuar në pozitën: "Udhëheqëse i Divizionit të Projekteve", në Departamentin e Infrastrukturës Rrugore të Ministrisë së Infrastrukturës (tani – Ministria e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës), dhe pretendimet e ankuesit janë të bazuara lidhur për faktin se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit në e-mailin e datë 26.07.2022 drejtuar ankuesit i ka bashkangjitur rivlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, dhe në njëjtin me e-mail e njofton lidhur me zbatimin e Vendimit me numër Anr.186/2022 i datës 12.04.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka bërë përpjekje me kërkesën përmes emailit të datës 12.09.2022, drejtuar Njësisë së personelit ku ndër të tjera, ka kërkuar: *provat shtese konkretisht komunikimin zyrtar lidhur ndërmjet ankuesit dhe udhëheqësit të tij të drejtpërdrejtë lidhur me vlerësimin e punës dhe përmbushjen e objektivave të punës si dhe shkresat tjera relevante* konform konstatimeve të Vendimit Anr.186/2022 të datës 12.04.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pas pranimit të ankesës së ankuesit të datës 03.08.2022 për rishqyrtim të rivlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021, dhe në bazë të përgjigjes së datës 27.09.2022 të Njësisë së Personelit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, është konfirmuar se edhe përkundër faktit që e kanë njoftuar Drejtorin e Departamentit të Infrastrukturës Rrugore me date 13.09.2022, i njëjti nuk ka dhënë përgjigje dhe nuk ka ofruar provat e kërkuar për këtë çështje, gjegjësisht Kolegji konstaton se organi i punësimit nuk ka arritur të dëshmojë me fakte dhe prova të ligjshme se cilat kanë qenë realisht objektivat e punës të ankuesit për vitin 2021 për të cilat janë pajtuar ankuesi me udhëheqësin e tij, siç përcaktohet me nenin 6 paragrafi 1, 3 dhe 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: "1. Brenda muajit Janar të vitit për të cilin bëhet vlerësimi i rezultateve në punë apo brenda tre (3) muajve të parë të emërimit të nëpunësit, mbikëqyrësi (vlerësuesi) së bashku me nëpunësin (i vlerësuar) përcaktojnë dhe pajtohen me objektivat dhe me planin e aktiviteteve për arritjen e objektivave të përcaktuara për vitin për të cilin vlerësohet; 3. Objektivat dhe plani i aktiviteteve për arritjen e objektivave përcaktohen me shkrim sipas afateve në paragrafin 1 të këtij neni dhe vendosen në formularin e vlerësimit (Formularin 1) si dhe shërbejnë si bazë për vlerësimin vjetor të nëpunësit. Formularin 1 është shtojcë dhe pjesë përbërëse e kësaj Rregullore. 4. Përcaktimi i objektivave, bazohet në objektivat e institucionit dhe në përshkrimin përkatës të punës së nëpunësit".



Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në ankesë, Kolegji ka analizuar nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: *Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e paracaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit. 3. Objektivat përcaktohen me shkrim, në fillim të vitit, në muajin janar, së bashku me planin e veprimtarive për arritjen e objektivave. 4. Objektivat përcaktohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me nëpunësin dhe e bëjnë me dije atë.. dhe nenin 5 paragrafin 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se : *Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të paracaktuar; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar).*, rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji nuk ka gjetur asnjë dëshmi sipas të cilës konstatohet se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me ankuesin kanë përcaktuar objektivat e punës në fillim të vitit 2021 konkretisht ankuesi ne ankese deklaroi se nuk posedon plan individual të punës për vitin 2021, e që është në kundërshtim me nenin 6 paragrafin 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku theksohet se : *“Përcaktimi i objektivave, bazohet në objektivat e institucionit dhe në përshkrimin përkatës të punës së nëpunësit”*, sepse plani i punës duhet të hartohet gjithmonë me pajtim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë dhe nëpunësin, duke marrë për bazë përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit dhe nga ajo pjesë duhet të caktohen objektivat përkatëse për realizimin e aktiviteteve, siç ceket edhe ne nenin 6 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurës e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku theksohet se : *“Brenda muajit janar të vitit për të cilin bëhet vlerësimi i rezultateve në punë apo brenda tre (3) muajve të parë të emërimit të nëpunësit, mbikëqyrësi ( vlerësuesi) së bashku me nëpunësin ( i vlerësuar) përcaktojnë dhe pajtohen me objektivat dhe me planin e aktiviteteve për arritjen e objektivave të paracaktuara për vitin për të cilin vlerësohet”*.*

Lidhur me pretendimin e ankuesit i cili pretendon se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021, është nxjerrë jashtë afatit ligjor, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar provat e lëndës të ankuesit dhe organi të punësimit gjegjësisht Ministria e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka konstatuar se pretendimi i ankuesit është i bazuar sepse formulari i vlerësimit për rezultatet e punës për vitin 2021 i ankuesit i është dorëzuar me datë 04.02.2022 nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë respektivisht nga Drejtori i Departamentit të Infrastrukturës Rrugore, i nënshkruar me datë 05.02.2022, jashtë afatit ligjor, ashtu siç përcaktohet me dispozitën ligjore të nenit 43 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, ku theksohet se: *“... Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues”*, lidhur me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: *“2. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin paraprak”* si dhe në kundërshtim



me nenin 8 paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: *“Vlerësimi përfundimtar i realizimit të objektivave dhe i aftësive profesionale të nëpunësit bëhet në fund të periudhës vlerësuese në bazë të një procesi, që përfshin: 1.1. takimi për diskutimin e realizimit të objektivave dhe rezultateve të arritura; 1.2. vlerësimin (notimin) e objektivave”*, sepse në rastin konkret vlerësimi i është dërguar ankuesit përmes e-mailit zyrtar që është në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 8 të kësaj Rregullore, ku përcaktohet se: *“Formulari i vlerësimit siç përcaktohet në paragrafin 3 të këtij neni i dërgohet nëpunësit, i cili diskutohet në një takim me mbikëqyrësin dhe në afat prej 5 dite kalendarike nëpunësi duhet të shprehet (pajtohet ose nuk pajtohet) me vlerësimin e mbikëqyrësit”*, që në rastin konkret organi i punësimit nuk e ka dëshmuar me asnjë provë se ankuesi është kontaktuar nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, për të diskutuar lidhur me periudhën e vlerësimit dhe po ashtu edhe rivlerësimit, dhe mbi këtë bazë ankuesi pasi ka pranuar ri-vlerësimin e datës 26.07.2022 i ka dhënë me shkrim komentet lidhur me mospajtimin e tij ndaj ri-vlerësimit të datës 26.07.2022, në pajtim me dispozitën e lartë cekur.

Andaj, pas vlerësimit të provave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe pas analizimit të dispozitave ligjore në fuqi, si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit duke u bazuar në gjeturat e pasqyruara si më lartë në këtë vendim, Kolegji ka ardhur në përfundimin se ekziston baza e mjaftueshme ligjore sikurse edhe faktike me prova konkrete se ankuesi në bazë të vlerësimit tek pjesa e objektivave me notë nga vlerësuesi i ka arritur objektivat, andaj është e palogjikshme që në pjesën e III tek *„Vlerësimi në bazë të sjelljeve profesionale”* pika 1.4 *„Iniciativa dhe kreativiteti”* dhe pika 1.5 *„Komunikimi dhe Përfaqësimi”* të thuhet se ankuesit i mungon iniciativa dhe komunikimi, përfaqësimi dhe angazhimi, e të vlerësohet me notën me të ultë, ndërsa në anën tjetër ankuesi në bazë të vlerësimit ka arritur të përmbushë objektivat, logjikisht pa initiative komunikim dhe angazhimin e ankuesit nuk do të mund të arriheshin objektivat. Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që ankuesi në bazë të formularit për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 31.12.2019 është vlerësuar me notë të përgjithshme 4.65, po nga i njëjti vlerësues për të njëjtat objektiva dhe aftësi, ndërsa për vitin 2021 është vlerësuar shumë me ulët, konkretisht vetëm tek pjesa e III tek *„Vlerësimi në bazë të sjelljeve profesionale”* pika 1.4 *„Iniciativa dhe kreativiteti* në vitin 2019 thuhet se ankuesi ka *„vetiniciative të madhe, nganjëherë i tejkalon edhe pritjet në këtë aspekt”* mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se ankuesi ka arritur objektivat dhe sipas nenit 13 paragrafin 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike *„Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas pranimit të ankesës në afatin ligjor, vendos duke miratuar apo ndryshuar vlerësimin e mbikëqyrësit (vlerësuesit)”*, andaj të njëjtit vendosi t'i ndryshojë notën e përgjithshme të vlerësimit për vitin 2021, gjegjësisht notën e përgjithshme mesatare nga dy pikë një(2.1) në dy pikë pesë (2.5), siç përcaktohet me dispozitat e nenit 11 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 si dhe paragrafit 2 nën paragrafit 2.3 i të njëjtit nen të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: *“Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton “ mirë”; dhe Kuptimi i notave si në paragrafin 1 të këtij neni është si në vijim: “ mirë”, vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës”*.



Bazuar në dispozitat ligjore të nenit 43 paragrafin 1 ,2 paragrafin 3 ,7 dhe 10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, është konstatuar se rivlerësimi për rezultatet e punës për vitin 2021 për ankuesin është bërë në kundërshtim me nenin 6, 7 dhe 8 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik, nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe si i tillë është i pa ligjshëm siç e përcakton dispozita ligjore e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *"1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:....1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative"*.

Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, është e obliguar që në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi, vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2021 të zëvendëson me këtë vendim.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda A.nr.686/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse



Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës
- Arkivit të KPMSHCK- së .